

SPECIFIKIMI I ÇMIMEVE

OBJEKTI : RRIVESHJE RRUGE ME ASFALT + KALLDREM

Germim dheu seksion I detyruar shkarkim ne mjet

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m³ germim dheu per kanalet e ujrave te bardha themeleve te mureve mbajtes dhe zgjerimin e rruges , panvaresisht nga kategoria e tokes ose menyra e realizimit te tij me mjete te mekanizuar dhe shkarkim ne mjet. Germimi te behet duke patur parasysh detajet teknike dhe permasat sipas profilave gjatesor dhe terthor.

Transport dheu+ mbeturina

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per transportin I dherave dhe mbeturine ne nje vend te caktuar nga Investitori por jo me larg se 1 km nga objekti.

Shtrese asfaltobetoni 5 cm

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m² shtrese asfaltobetoni ne rrugen, me trashesi 5 cm, pas ngjeshjes me rul 12 ton , dhe siguron pjerresite sipas profilave gjatesor dhe terthor, ne cmim futet teresia e shpenzimeve blerjen e asfaltit , transportin sipas kushteve teknike shperndarjen e tij ne kasoneten e rruges dhe ngjeshjen e tij me rul 12 ton sipas kushteve teknike . Shtrimi I asfaltit te behet me makine shtrimi dhe ne nje kohe te pershtateshme .Asfaltobetoni te plotesoje te gjitha kushtet teknike , shoqeruar me certificate cilesie .Ne siperfaqe te mos kete gropeza per mbajtjen e ujit. Ne cmim futet dhe testet e bera per standartin e asfaltit.

Ndertim mur guri mbajtes llac cemento M 25

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m³ mur guri mbajtes ll.c. M=25 per ndertimin e mureve sipas detajit teknik me gjeresi dhe lartesi sipas projektit , pjesa ballore muret do te behet me fugatim. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per blerjen e materialeve rere guri, cemento, gure gerqelore, transportin. Ne cmim futet dhe testet e bera per marken e gurit. Llaci te prodhohet me betoniere ne objekt sipas kushteve teknike dhe standartet, me rere guri, te realizohet marka e kerkuare llacit.

F.V. Bordura parafabrikat betoni C – 16 /20 .

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 ml bordure ne rruge dhe trotuar. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per blerjen e bordureve parafabrikat betoni, transportin shperndarjen e tyre,si dhe vendosja e tyre me topograf. Fiksimi I bordurave do te behet ne beton C – 16 / 20. Bordurat duhet te jene te shoqeruar me certifikaten e cilesise.

Shtrese me pllaka granili veteshternguese t = 6 cm

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m² shtrese pllake ne trotuar pas berjes se shtreses reres duke patur parasysh

kuotat e trotuarit. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per blerjen e pllakave parafabrikat betoni t = 6cm, transportin shperndarjen e tyre,si dhe vendosja e tyre mbushjen e fugave me rere. Pllakat duhet te jene te shoqeruar me certifikaten e cilesise.

F.V. Tub korogato Ø = 200mm

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per furnizimin dhe vendosjen e 1 ml tubo korogato Ø = 200. ne veper qe ploteson te gjitha kushtet teknike dhe kerkesave te projektit. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per piketimin, blerjen e materialeve, transportin dhe vendosjen ne veper sipas profilave terthor. Tubot duhet te jene te shoqeruar me certifikaten e cilesise

Shtrese material I bute mbi dhe nen tubo

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m3 shtrese material bute mbi dhe ne tubot e P.V.C. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per zgjedhjen e mateijalit rere, transportin shperndarjen e tij mbi dhe ne tubot plastike. Materiali bute te plotesoje te gjitha kushtet teknike te mos kete gure.

Mbushje me cakell

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m3 cakell me trashesi shtrese 30-40 cm mbi materialin e bute ne tubot korogato Ø 200 mm .Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per blerjen e materialit , transportin shperndarjen e tij ne rruge dhe ngjeshjen e tij me rul sipas kushteve teknike . Materiali duhet te jete cakell mbeturine gurore me perzjerje argjile jo me shume se 15 %.

Ndertim pusete me zgare gize per ujrat e shiut. C – 16 / 20

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 cop pusete shiu beton C – 16 / 20. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per germimin e dheut per prodhimin ose blerjen e materialeve inerte , cimento, transportin , pergatitjen e armaturave me derrese te stazhionuar ose metalike ,pergatitjen e betonit dhe hedhjen ne veper , ngjeshjen me vibrator , dhe trajtimin me uje per realizimin e markes te kerkuar dhe dizarmimin e armatures dhe per vendosjen e kapakun te gizes . Ne cmim futet dhe testet e bera per marken e betonit. Betoni te merret I gatshem nga nje nyje e mekanizuar ose te prodhohet me betoniere ne objekt sipas kushteve teknike dhe standartet, me rere guri + cakell, te realizohet marka e kerkuare betonit. Ne cmim futet dhe testet e bera per marken e betonit.